



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:012129

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06517197

Pml.nr.650/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Mejreme Memaj, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit M. H., nga fshati B., komuna e M., për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 3 e lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.245/2024 të datës 13.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës e të dënuarit M. H., për mbrojtje të ligjshmërisë, anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.245/2024 të datës 13.05.2024 dhe çështja i kthehet kësaj gjykate në rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.405/2021 e datës 26.12.2024, të dënuarin M. H., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I dënuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe në emër të kompensimit të

viktimave të krimit shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pala e dëmtuar Sh. I. ka hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike në këtë çështje penale.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.245/2024 e datës 13.05.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit M. H., dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- i dënuari M. H., për shkak të shkeljeve të kodit të procedurës penale dhe shkeljes së kodit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë kërkesën si të tillë dhe ti shfuqizoi në tërësi aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthejinë shqyrtim dhe vendosje të sërishme.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.228/2024 e datës 28.06.2024, ka propozuar që kërkesa e të dënuarit M. H. për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë i dënuari ndër të tjera thekson se në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.05.2024, e ku ka marrë pjesë mbrojtësi avokat Dijar Dinaj, që për të njëjtën seance ai nuk e ka informuar, se nuk ka pasur ftesë në procedurën ankimore nga ana e Gjykatës së Apelit e Kosovës dhe se në këtë mënyrë i është cenuar e drejta që para kësaj gjykate ti paraqes arsyet e ankesës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i të dënuarit për mos informimin për seancën e shkallës së dytë është i bazuar, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është marrë pa informimin e të dënuarit.

Siç rezulton në shkresat e lëndës kolegjii penal i gjykatës së shkallës së dytë, i cili duke vepruar sipas ankesës së mbrojtësit të dënuarit, ka caktuar shqyrtimin publik dhe me këtë rast nuk e ka njoftuar të njëjtin për datën e seancës, edhe pse sipas nenit 390 par.1 të KPP-së, ka pasur obligim që të njëjtin ta njoftoj. Mosardhja e tij, pas njoftimit të rregullt, konform nenit 390 par.6 të KPP-së, nuk do të pengonte mbajtjen e seancës së kolegjit të shkallës së dytë. Andaj, me këtë i është pamundësuar që t'i paraqes pretendimet e tij në seancën e kolegjit, ashtu që rrjedhimisht, përveç që është shkel neni 390 i KPP-së, në këtë rast ka pasur edhe shkelje të drejtës

për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 par.1 dhe 3 pika (c) dhe (d) i KELDNj.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në ekzistimin e kësaj shkelje nuk ka vlerësuar shkeljet tjera të pretenduara meqenëse është evidente që të dënuarit i është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe pjesëmarrja e tij në seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë e cila kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë duke u bazuar në nenin 384 par.2, nënpar.2.2 të KPP-së.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.650/2024, më 19 nëntor 2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala